



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 303, datë 05.06.2023

PËR

**KRIJIMIN E KOMISIONIT TË RISTRUKTURIMIT TË GJYKATAVE
ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË DURRËS, KORÇË DHE SHKODËR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 147/a të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, nenit 61, 90, 95 dhe 96 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Vendimit të KLGJ-së nr. 271, datë 25.05.2023 "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar", Vendimit të KLGJ-së nr. 557, datë 29.12.2022 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit”, të ndryshuar me Vendimin nr. 285, datë 29.05.2023, Vendimit nr. 14, datë 02.06.2023, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë “Për miratimin e strukturës organizative, organigës dhe përshkrimeve të punës të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër, me përbërje:
 - Z. {...}– Kryetar (përfaqësues i KLGJ-së);
 - Z. {...}– Anëtar (Zv.Kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës);
 - Zj. {...}– Anëtar (Zv.Kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë);
 - Zj. {...}– Anëtar (Zv.Kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër);
 - Zj. {...}– Anëtar (Zv.Kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë);
 - Zj. {...}– Anëtar (Kancelar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës);
 - Z. {...}– Anëtar (Kancelar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë);
 - Zj. {...}– Anëtar (Nëpunës që ushtron detyrat e Kancelarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër);
 - Zj. {...}– Anëtar (Kancelar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë).
2. Komisioni i Ristrukturimit i Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër, i cili ushtron funksionet pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, do të shqyrtojë mundësinë e sistemit të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë

Durrës, Korçë dhe Shkodër, që i nënshtrohet riorganizimit, në strukturën dhe organikën e gjykatës pritëse (Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë).

3. Komisioni i Ristrukturimit, do të shqyrtojë edhe mundësinë e sistemimit të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër, në strukturat e Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Korçë dhe Shkodër.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR